



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI**  
**AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST**  
**INFORMATION AND PRIVACY AGENCY**



Nr. 04/2021  
Datë: 13.09.2021

**Komisionerja e Agjencisë për Informim dhe Privatësi,**  
Në mbështetje të nenit 45. 46. dhe 58. të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, merr:

**V E N D I M**

1. Aprovohet lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.
2. Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale i bashkëngjitet këtij vendimi.
3. Lista e aprovuar sipas pikës 1. të këtij vendimi publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në web faqen zyrtare të Agjencisë.
4. Shfuqizohet Vendimi Nr.11/2020, datë 06.02.2020.
5. Vendimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit.

Krenare **SOGOJEVA DERMAKU**

Komisionere për Informim dhe Privatësi



Vendimi i dërgohet.

- Gazetës Zyrtare
- Drejtorit të Përgjithshëm
- Drejtorëve të Departamenteve
- Arkivit të Agjencisë

**Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare që cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale përmban shtetet si më poshtë:**

- Austri
- Belgjikë
- Bullgari
- Kroacia
- Qipro
- Republika Çeke
- Danimarkë
- Estoni
- Finlandë
- Francë
- Gjermani
- Greqi
- Hungari
- Irlandë
- Itali
- Letoni
- Lituani
- Luksemburg
- Maltë
- Holandë
- Poloni
- Portugali
- Rumani
- Sllovaki
- Slloveni
- Spanjë
- Suedi

**Shtetet anëtare të “Zonës Ekonomike Evropiane” konkretisht listohen:**

- Islandë
- Lihtenshtein
- Norvegji
- Zvicër

Në mbështetje të nenit 46. (paragrafi 2) përcaktohet se “Agjencia mund të zbatojë vendimet e marra nga organi kompetent i Bashkimit Evropian nëse vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave”. Organi kompetent i Bashkimit Evropian ka përcaktuar edhe shtetet si më poshtë:

**1. Argjentinë**

Vendim i Komisionit C(2003) 1731 i datës 30 Qershor 2003 - OJ L 168, 5.7.2003.

(Opinion 4/2002 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në Argjentinë, dokumenti Nr. Grupi i Punës 63);

**2. Andorra**

Vendimi i Komisionit i datës 19 Tetor 2010 në përputhje me Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi mbrojtjen adekuate të të dhënave personale nga Andorra ( i njoftuar sipas dokumentit C(2010) 7084);

### **3. Kanada**

Vendim i Komisionit 2002/2/EC i datës 20.12.2001 për mbrojtjen e mjaftueshme të dhënave nga Ligji Kanadez për Mbrojtjen e Informacionit Personal dhe Dokumenteve Elektronikë - O.J. L 2/13 of 4.1.2002 (Opinion 2/2001 për mbrojtjen e mjaftueshme të dhënave nga Mbrojtja e Informacionit Personal Kanadez dhe Dokumenteve Elektronikë Akti, dokumenti Nr. Grupi i Punës 39);

### **4. Guernsey**

Vendim i Komisionit i datës 21 Nëntor 2003 për mbrojtjen e mjaftueshme të dhënave në Guernsey (njoftuar sipas dokumentit numër C(2003) 4309).

### **5. Ishulli i Man**

Vendim i Komisionit i datës 28 Prill 2004 për mbrojtjen e mjaftueshme të dhënave në Isle of Man (i njoftuar sipas dokumentit numër C(2004) 1556);

### **6. Jersey**

Vendim i Komisionit i datës 8 Maj 2008 në përputhje me Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së dhënave në Jersey (i njoftuar sipas dokumentit numër C(2008) 1746);

### **7. Ishujt Faroe**

Vendim i Komisionit i datës 5 Mars 2010 në përputhje me Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së dhënave personale të parashikuar në aktin e Ishujve Faroe për përpunimin e dhënave personale (i njoftuar sipas dokumentit C(2010)1130);

### **8. Izraeli**

Vendimi i Komisionit i datës 31 Janar 2011 në përputhje me Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi mbrojtjen adekuate të dhënave personale nga Shteti i Izraelit në lidhje me përpunimin e automatizuar të dhënave personale (i njoftuar sipas dokumentit C(2011) 332);

### **9. Zelanda e Re**

Vendimi i Komisionit i datës 19 Dhjetorit 2012 në përputhje me Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së dhënave personale nga Zelanda e Re (i njoftuar sipas dokumentit C(2012) 9557);

### **10. Uruguai**

Vendimi i Komisionit i datës 21 Gusht 2012 në përputhje me Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së dhënave personale nga Republika Lindore e Uruguajt në

lidhje me përpunimin e automatizuar të të dhënave personale ( i njoftuar sipas dokumentit numër C(2012) 5704);

### **11. Japonia**

Vendimi i Komisionit i datës 23 Janar 2019 sipas Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për mbrojtjen e duhur të të dhënave personale nga Japonia në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Informacionit Personal ( i njoftuar sipas dokumentit C(2019)304);

### **12. Mbretëria e Bashkuar**

Vendimi i Komisionit i datës 26 Qershor 2021 sipas Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për mbrojtjen e duhur të të dhënave personale nga Mbretëria e Bashkuar ( i njoftuar sipas dokumentit C(2021) 4800);